



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE – ADMINISTRATIVE
SEKTORI I STANDARTEVE DHE I KURRIKULAVE

Gjirokastrë, më 06 / 03 / 2020

Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e "Ditëve të Informimit të Maturantëve"

Në kuadër të nismës "Për njohjen dhe informimin e maturantëve me institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë", nga data 18 shkurt deri më 3 mars 2020, Universiteti i Gjirokastrës zhvilloi fushatën "Ditët e informimit të maturantëve".

Anëtarë të stafit akademik të këtij Universiteti, organizuan takime me maturantët, në shkollat e mesme të Rajonit Jugor, duke e shtrirë aktivitetin e tyre edhe në rrethin e Sarandës, në Fier dhe në Berat.

Këto takime patën për qëllim promovimin e programeve të studimit që ofron Universiteti "Eqrem Çabej", si dhe njohjen me kriteret e pranimit. Kurrikulat, stafi akademik, kushtet dhe lehtësirat financiare janë ndër kriteret kryesore në përzgjedhje, të cilat UGJ, si një Universitet i konsoliduar dhe i akredituar, ka ditur t'i ndërthurë dhe t'i ofrojë më së miri.

Gjatë këtyre takimeve, si dhe pranë "Këndit të Informimit" të ngritur në mjediset e universitetit, por edhe në rrjetet tona sociale, maturantët kanë treguar interes për programet, sistemin e bursave, programet Erasmus si dhe mundësitë që ofrohen pas përfundimit të studimeve.

Në kuadër të kësaj fushate informimi, UGJ mori pjesë dhe në "Ditët e Hapura për Maturantët", organizuar nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Gjirokastrë, në datat 27 dhe 28 mars 2020, në mjediset e teatrit "Zihni Sako".

Universiteti i Gjirokastrës, gjatë këtyre dy ditëve, prezantoi ofertën e tij akademike 2020 – 2021 nëpërmjet fletëpalosjeve, revistave, videove me veprimtari të ndryshme etj.


Për një karrierë të sigurt është motoja që na ka shoqëruar në udhëtimin tonë gjysmëshekullor.

Për 10 ditë me radhë matuantët e rajonit jugor janë informuar mbi ofertën tonë akademike, jetën studentore në UGJ, programet e studimit, mundësitë e zhvillimit të karrierës dhe avantazhet e të qenurit pjesë e një universiteti të akredituar.



Maturantët patën komunikime të detajuara me pedagogët e fakulteteve të universitetit rreth lëndëve, duke u orientuar kështu se në cilën prej degëve të Universitetit të Gjirokastrës mund të studiojnë në vazhdim. Fushata promovuese e UGJ pranë shkollave të mesme të sistemit parauniversitar është kthyer tashmë në traditë.








WWW.UOGJ.EDU.AL

Ditët e informimit matura 2020





INFORMIMI I
MATURANTEVE

DITA I



UNIVERSITETI
GJIROKASTRES

WE HELP
YOU SHAPE
YOUR FUTURE.

